



Partnerët Shqipëri, Qendra për Ndryshim dhe Manaxhim Konflikti

**DOKUMENT POLITIKASH
PROKURIMI SOCIAL NE SHQIPERI**

Nëntor 2014



B | T | D The Balkan Trust
for Democracy
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND



**OLOF PALME
INTERNATIONAL
CENTER** 

Ky Dokument Politikash vjen si pjesë e iniciativës afatgjatë të Partnerëve Shqipëri për të advokuar për një mjedis mundësues për zhvillimin e organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri. Ai është në linjë me platformën e diskutuar dhe rënë dakord midis aktorëve të organizatave të shoqërisë civile dhe shtetit në Konferencën Kombëtare “Partnerë Socialë – Koha për Veprim”, organizuar në Dhjetor 2013.

Ky Dokument Politikash është përgatitur nga Partnerët Shqipëri me asistencën e Luben Panov, ekspert ndërkombëtar, Drejtor Programi pranë Qendrës Evropiane për Ligjin Jofitimprurës (ECNL).

Mbështetja financiare është ofruar nga Bashkimi Evropian, dhe Olof Palme Center International në Shqipëri nëpërmjet financimit të Qeverisë Suedeze.

Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e autorit dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian, Olof Palme International Center në Shqipëri apo Qeverisë Suedeze.

TABELA E LËNDËS

I. PËRMBLEDHJE	4
II. HYRJE.....	5
III. ÇFARË ËSHTË KONTRAKTIMI/PROKURIMI SOCIAL DHE PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM?6	
3.3. Faktorët kryesorë që përcaktojnë kontraktimin social.....	7
3.4. Llojet e mbështetjes për OSHCtë	7
3.5. Specifikat e kontraktimit social	8
3.6. Cili është një kuadër që mbështet prokurimin social nga OSHCtë?.....	9
3.7. Cilat janë përfitimet e kontraktimit social?	10
IV. SHËMBUJ NDËRKOMBËTAR RRETH FUNKSIONIMIT TË PROKURIMIT SOCIAL	10
4.1. Modele vendesh.....	10
4.2. Rregullorja e BEsë.....	12
V. MJEDISI LIGJOR PËR KONTRAKTIMIN E SHËRBIMEVE SOCIALE TE OSHC-TË NË SHQIPËRI.....	12
5.1. Mundësitë e OSHCve për t’u përfshirë në aktivitet ekonomik	12
5.2. Ofrimi i shërbimeve sociale (bazuar në rishikimin e Ligjit Nr.9335/10.03.2005 për ndihmën dhe shërbimet shoqërore)	13
5.3.Procedura për prokurimin e shërbimeve (bazuar në një rishikim të Ligjit për prokurimet publike nr 9643 / 20.11.2006 ndryshuar me ligjin nr. 131/2012).....	14
VI. PRAKTIKA LIDHUR ME KONTRAKTIMIN E SHËRBIMEVE SOCIALE TE OSHC-të	16
VII. REKOMANDIME	21
VIII. SHTOJCA.....	24
8.1. Rast Studimor - Komuniteti Emanuel, Korçë.....	24
8.2. Lista e të Intervistuarve	25
8.3. Pjesëmarrësit në grupe të fokusuara me OSHCtë.....	26

I. PËRMBLEDHJE

Në Shqipëri, si në vendet e tjera, shteti ka detyrimin të ofrojë shërbime sociale për qytetarët, që rezultojnë nga konventat dhe traktatet ndërkombëtare që shteti ka ratifikuar dhe nënshkruar si dhe nga kuadri ligjor dhe rregullator kombëtar. Shteti ka gjithashtu detyrimin të sigurojë që ekziston një kuadër ligjor i qartë dhe mbështetës për ofrimin e shërbimeve sociale, që mundëson ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët.

Legjislacioni Shqiptar përcakton që ekzistojnë shërbimet sociale publike të financuara nga shteti dhe shërbimet sociale private të financuara me fonde private. Ndërkohë që shumë shpesh OSHCtë me fonde nga donatorët e huaj sigurojnë ofrimin e shërbimeve sociale që nuk ofrohen nga shteti, përgjegjësia e shtetit që shërbimet të ofrohen përfshin edhe sigurimin e fondeve për shërbimet. Bazuar në legjislacionin në fuqi, kontraktimi i shërbimeve të ofruesit privatë, OSHC apo ofrues të tjerë, duhet të bëhet sipas rregullave dhe procedurave të Ligjit të Prokurimit Publik. Zbatimi i këtij ligji për kontraktimin e shërbimeve sociale është konsideruar problematik si nga institucionet shtetërore edhe nga OSHCtë për arsye të ndryshme që përmenden në këtë dokument politikash, që kërkon një nevojë urgjente për prezantimin e praktikave të Prokurimit Social në Shqipëri, që është procesi nëpërmjet të cilit shteti kontraktin ofrimin e shërbimeve sociale të ofruesit privatë. Ky dokument do të fokusohet në mënyrën se si kjo mund të ndodhë në Shqipëri.

Pjesa e parë e dokumentit prezanton një përshkrim të kontraktimit/prokurimit social dhe rëndësinë e tij në fushën e ofrimit të shërbimeve sociale, kuadrin mbështetës për prokurimin social të OSHCve, si dhe disa modele të aplikimit të tij në vende të ndryshme.

Pjesa e dytë e dokumentit i dedikohet analizës së situatës në Shqipëri në lidhje me legjislacionin ekzistues dhe praktikën, duke identifikuar faktorët kryesorë që pengojnë prokurimin social në Shqipëri: Mungesa e traditës në ofrimin e shërbimeve sociale me bazë komunitare; Mungesa e fondeve shtetërore për shërbimet sociale; Mungesa e procedurave të përshtatshme për kontraktimin e shërbimeve; Mungesa e kapaciteteve për të kontaktuar shërbimet; Vonesat dhe probleme të tjera që lidhen me pagesat; OSHCtë konsiderohen si një burim dhe jo marrës fondesh, etj.

Pjesa e fundit e dokumentit ofron rekomandime që do të sigurojnë që kontraktimi social jo vetëm është i mundur, por është edhe një praktikë që udhëheq ofrimin dhe financimin e shërbimeve sociale në Shqipëri, si: përfshirjen e kontraktimit social në dokumentet politike që po zhvillohen; përcaktimin e elementëve kryesorë të mekanizmave të kontraktimit social; përcaktimin e qartë të përgjegjësive të autoriteteve lokale në ofrimin e shërbimeve sociale; sigurimin e fondeve për ofrimin e shërbimeve sociale me bazë komunitare; rritjen e kapaciteteve të OSHCve dhe institucioneve dhe pjesëmarrjen e OSHCve në të gjitha fazat e zhvillimit të shërbimeve sociale.

Si konkluzion, dokumenti vlerëson se situata aktuale politike, me zhvillimin dhe ndërmarrjen e disa reformave të rëndësishme, prezanton një mundësi unike për zhvillimin dhe zbatimin e suksesshëm të prokurimit social. OSHCtë, me ekspertizën dhe eksperiencën e gjatë në fushën e shërbimeve sociale, do të jenë një partner natyral i shtetit në këtë proces.

II. HYRJJE

Gjatë tre dekadave të fundit të zhvillimit të tij, sektori i OSHCve në Shqipëri është zgjeruar në ofrimin e shërbimeve dhe produkteve për grupe dhe komunitete të ndryshme, dhe prania e tij ka qenë më shumë e dukshme, duke ofruar një kontribut të çmuar në mirëqenien e qytetarëve. Pavarësisht përpjekjeve dhe përmirësimeve në marrëdhëniet midis shtetit dhe OSHCve, si rezultat i iniciativave nga të dyja palët për të vendosur një partneritet efektiv dhe të qëndrueshëm, ende shteti nuk e njih plotësisht rëndësinë dhe vlerën e OSHCve si një partner i pazëvendësueshëm në zhvillimin e vendit.

OSHCtë janë partnerë të shtetit në ofrimin e shërbimeve sociale. Ato përfaqësojnë një kategori kryesore të ofruesve të shërbimeve në fushat tradicionale të shërbimeve sociale, si kujdesi dhe asistenca sociale, kujdesi shëndetësor, arsimiti, etj. Shumë OSHC në Shqipëri ofrojnë shërbime sociale që janë plotësuese të shërbimeve që shteti ka për detyrim t'i ofrojë, dhe gjithashtu kanë krijuar një seri shërbimesh sociale që nuk ofrohen nga shteti apo nga ofrues të tjerë shërbimesh, duke qenë në këtë mënyrë ndër ofruesit kryesorë, për të mos thënë të vetmet, në ofrimin e këtyre shërbimeve, si p.sh. shërbimet për personat me varësi nga drogat, etj. OSHCtë janë më pranë nevojave të njerëzve dhe mund të sjellin një vlerë të shtuar në përcaktimin e nevojave për shërbime, si dhe për mënyrën se si ato mund të adresohen më mirë. Përveç kësaj, OSHCtë kanë ekspertizën dhe mund të ofrojnë një perspektivë tjetër në procesin e vlerësimit të shërbimeve të ofruara nga shteti.

Legjislacioni shqiptar njih dhe lejon bashkëpunimin midis shtetit dhe OSHCve në fushën e shërbimeve sociale, dhe ligji nuk i përjashton OSHCtë nga ofrimi i shërbimeve sociale publike, si dhe shërbimeve të tjera që ato mund të ofrojnë. Por, praktika tregon se ka pak raste sporadike, të iniciuara kryesisht nëpërmjet projekteve të donatorëve të huaj, ku shteti nëpërmjet mekanizmave dhe procedurave të ndryshme ka kontraktuar OSHCtë për të hartuar, ofruar, apo vlerësuar shërbimet sociale publike. Në një situatë kur të gjithë palët e pranojnë rëndësinë dhe nevojën e transferimit të ofrimit të shërbimeve sociale tek OSHCtë, ende mungon një procedurë e rregulluar për kryerjen e këtyre praktikave.

Kjo situatë evidentohet edhe në Matricën e Monitorimit të Mjedisit Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile¹, në të cilën bashkëpunimi në ofrimin e shërbimeve është një ndër fushat e matura. Raporti tregon se vetëm 8% e OSHCve kanë përfituar nga kontratat shtetërore për ofrimin e shërbimeve publike, përfshi shërbimet sociale. Sfidat të ndryshme janë paraqitur nga OSHCtë dhe përfaqësuesit e institucioneve publike, veçanërisht në nivel vendor, ku ndodh edhe shumica e kontraktimeve, në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë që kanë njësitë e qeverisjes vendore në ofrimin e shërbimeve publike. Midis të tjerash, shumë probleme lidhen me zbatimin e dy ligjeve kryesore në këtë fushë:

1. Ligj Nr. 9355, datë 10.03.2005 Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore
2. Ligji mbi Prokurimin Publik Nr. 9643/20.11.2006 ndryshuar me ligjin nr. 131/2012

Duke marrë në konsideratë sa më sipër, ky Dokument politikash prezanton praktikën e Kontraktimit/Prokurimit Social, me qëllim final propozimin e mekanizmave të duhur për transferimin e ofrimit të shërbimeve sociale nga shteti te OSHCtë në Shqipëri

¹ Matrica e Monitorimit të Mjedisit Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, RAPORTI PER SHQIPERINE, Partnerët Shqipëri

III. ÇFARË ËSHTË KONTRAKTIMI/PROKURIMI SOCIAL DHE PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM?

3.1. Detyrimi i shtetit për të ofruar shërbime

Shtetet kanë detyrimin të ofrojnë disa shërbime të caktuara me interes publik ndaj qytetarëve. Ky detyrim rrjedh nga traktatet ndërkombëtare (p.sh. Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike Sociale e Kulturore; Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve; Konventa mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara etj) si dhe nga kushtetuta e ligjet e veta. Ky detyrim është pjesë e kontratës midis shtetit dhe qytetarëve. Shërbime të tilla zakonisht përfshijnë ndër të tjera, shërbimet në fushën sociale, kujdesin shëndetësor dhe fushën e edukimit.

Ndërkohë që shtetet mund të transferojnë ofrimin e shërbimeve tek ofruesit privatë, shtetet gjithmonë duhet të kenë përgjegjësinë që shërbimet t'i ofrohen përfituesve, dhe ky detyrim është i patjetërsueshëm. Në drejtimin e financimit, ndërkohë që OSHCtë apo donatorë të huaj janë në gjendje të mbështesin ofrimin e shërbimeve, përgjegjësia e shtetit që shërbimet të ofrohen përfshin njëkohësisht edhe sigurimin e financimit të shërbimeve.

Përveç garancisë që shërbimet u janë ofruar qytetarëve, shtetet gjithashtu kanë detyrimin të sigurojnë që kuadri ligjor për ofrimin e shërbimeve ekziston dhe është mbështetës. Një legjislacion i tillë përfshin, përveç përcaktimit të llojeve të shërbimeve dhe mënyrës se si ato do të ofrohen, edhe rregullat dhe mekanizmat përmes të cilave ofrimi i këtyre shërbimeve mund të transferohet tek ofruesit e pavarur. Ky dokument do të fokusohet në mënyrën se si kjo gjë mund të ndodhë në Shqipëri.

3.2. Terminologjia

Për qëllimet e këtij dokumenti, kontraktimi/prokurimi social do të quhet procesi përmes të cilit shteti kontraktin ofrimin e shërbimeve sociale tek ofrues privatë. Ne fokusohemi në fushën sociale sepse kjo është një fushë në të cilën:

- Shteti ka përgjegjësinë të ofrojë shërbime;
- Ka specifika të veçanta që diferencojnë procedurat nga prokurimi i përgjithshëm publik;
- OSHCtë janë të përfshira në mënyrë aktive dhe kanë kapacitetin për të ofruar shërbime;
- Ekzistojnë shumë shembuj pozitiv se si këto shërbime mund të kontraktohen;
- Ka një nevojë të vazhdueshme për më tepër efikasitet dhe efektivitet të sistemit social.

Kur flasim për shërbime sociale, nuk do të përfshijmë rrethin e gjerë të shërbimeve të cilat quhen shpesh shërbime publike, si kujdesi shëndetësor dhe edukimi, por do të fokusohemi në një përkufizim më të ngushtë të shërbimeve sociale që përfshijnë shërbimet që synojnë të ndihmojnë një person që të përfshihet në shoqëri dhe të përmirësojë cilësinë e jetës së tij/saj. Këto shërbime kanë si objektiv, njerëz në situata të pafavorshme (p.sh. njerëz të varfër, njerëz me paaftësi, etj.).

Përgjithësisht, ka dy mënyra kryesore për të ndihmuar njerëzit në situatë të pafavorshme:

- Përmes ofrimit të transfertave në para apo në një formë tjetër ndihme materiale (strehim pa qera, energji elektrike pa pagese, etj.); ose
- Përmes ofrimit të shërbimeve sociale.

Zakonisht lloji i parë i mbështetjes është brenda sferës së shtetit, kështu që prokurimi social fokusohet në fushën e dytë.

3.3. Faktorët kryesorë që përcaktojnë kontraktimin social

Ka disa çështje të rëndësishme që ndikojnë në procesin e prokurimit social. E para lidhet me faktin se **cilat institucione dhe në çfarë niveli kanë detyrimin për të ofruar shërbime sociale**. Ndonjëherë ky detyrim shtrihet në nivel kombëtar – një ministri ose agjenci të tjera. Shumë shpesh, ky detyrim është i decentralizuar – autoritetet lokale kanë detyrimin të kujdesen për nevojat e popullsisë në zonën e tyre.

Një çështje e dytë është se si financohen shërbimet – **financimi i shërbimeve vjen nga buxheti i shtetit apo ai është brenda sferës së buxhetit lokal?** Për më tepër, është e rëndësishme të dimë nëse institucioni që ka për detyrë ofrimin e shërbimeve ka në fakt edhe buxhetin për të siguruar që shërbimet të ofrohen.

Një çështje e tretë e rëndësishme lidhet me faktin se nëse ekziston vullneti për të transferuar ofrimin e shërbimeve tek një ofrues privat dhe ka fonde të mjaftueshme për të mbuluar kostot, **a ka ofrues të pavarur potencial për ofrimin e shërbimeve**. Ndonjëherë është e nevojshme që të investohet edhe në ngritjen e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve.

3.4. Llojet e mbështetjes për OSHCtë

Në fushën sociale, OSHCtë janë subjektet më tipike të kontraktuara për të ofruar shërbimet e deleguara nga shteti. Ka rrugë të ndryshme në cilat shteti mund të ofrojë financim për OSHCtë për të punuar në fushën sociale:

- **Subvencionet** – kjo është një formë mbështetje institucionale ose mbështetje për organizata specifike të cilat kanë një status të veçantë. Zakonisht këto përfshijnë shoqata që përfaqësojnë interesat e personave me aftësi të kufizuara. Ky financim jepet pa ndonjë konkurs dhe me kalimin e kohës mund të krijojë një grup organizatash të privileguara.
- **Grantet** – kjo është një formë mbështetje e ofruar kryesisht mbi baza konkurrimi. Grantet përdoren kur synimi është adresimi i disa problemeve por nuk përcaktohet mënyra se si kjo do të bëhet, p.sh. qeveria kërkon të luftojë dhunën në familje por nuk është e sigurt se cili është mjeti më i mirë për ta bërë këtë. Atëherë ajo nxjerr një thirrje për propozime dhe OSHCtë aplikojnë për fondin. Një OSHC mund të konsiderojë si mënyrën më të mirë mbështetjen e grave të dhunuara duke i ofruar atyre strehim pasi ato kanë pësuar dhunën. Një OSHC tjetër mund të propozojë të organizojë trajnime për njerëzit se si të veprojnë kur ndodh dhuna ose të trajnojnë njerëzit mbi efektet negative të dhunës në familje. Këto janë përjasje të ndryshme për të njëjtin problem. Pasi merren propozimet e ndryshme, qeveria vendos se cili i përshtatet më mirë qëllimit të saj. Grantet gjithashtu mund të përdoren për të ngritur kapacitetet e ofruesve të shërbimeve ose për të zhvilluar apo pilotuar shërbime të reja.

- **Prokurimi/ Kontraktimi-** kjo është mënyra më tipike për të “blerë” shërbime nga OSHCtë. Në këtë rast qeveria e di saktësisht çfarë lloj shërbimesh i duhet të marrë dhe shpall një tender përmes të cilit zgjedh ofruesin e këtyre shërbimeve (p.sh. krijimin e një strehëze për 50 gra që kanë përjetuar dhunë në familje). Gjatë zgjedhjes së ofruesit, qeveria vendos kriteret sipas të cilave do të marrë vendimin – çmimi më i ulët, oferta ekonomikisht më e vlefshme, etj.
- **Kuponët/pagesat ndaj palëve të treta** – Këto terma përdoren për të përshkruar një mekanizëm të ndarë, nëpërmjet të cilit nuk është shteti ai që përcakton se cili ofrues shërbimesh duhet të paguhet nga shteti, por janë përfituesit apo klientët ata që e bëjnë këtë përcaktim. Në këtë model shteti licencon ose autorizon një numër të gjerë ofruesish që të ofrojnë shërbime. Në këtë rast ai i jep të drejtën (ose në disa raste një dokument të veçantë të quajtur kupon) përfituesve në nevojë për shërbime, që të identifikojnë ofruesin e tyre të preferuar të shërbimeve. Bazuar në vendimin e klientit, shteti paguan ofruesin për shërbimet që ai ofron.

3.5. Specifikat e kontraktimit social

Ka disa çështje të rëndësishme të cilat duhet të merren në konsideratë kur vendoset se si zgjidhet ofruesi i shërbimeve:

1. Shërbimet sociale zakonisht ofrohen ndaj njerëzve që nuk mund të përballojnë të paguajnë për to. Pra nuk ka një treg të vërtetë për këto shërbime pa shtetin.
2. Në fushën sociale ka gjithmonë e më shumë nevoja sesa burime në dispozicion. Për më tepër, nevojat janë konstante dhe zakonisht afatgjata p.sh. t’i mundësosh një asistent personal një individ me aftësi të kufizuara nuk është diçka që mund të ofrohet për një vit dhe pastaj të ndërpritet.
3. Duke qenë se burimi kryesor i financimit për shërbimet sociale është buxheti publik (lokal dhe kombëtar), është e rëndësishme të dimë se (duke qenë se flasim për financim nga ana e shtetit), kursimet në buxhetet sociale mund të çojnë në ndërprerje të buxhetit për vitin e ardhshëm. Kështu që në vend që të kursehet në buxhet, autoritetet përgjegjëse për fushën sociale zakonisht përpiqen të përdorin maksimalisht dhe gjerësisht buxhetin e vlefshëm dhe të ofrojnë një cilësi më të lartë të shërbimeve ose të mbulojnë më tepër njerëz me të njëjtin buxhet.

Çdo mekanizëm që hartohet për të transferuar ofrimin e shërbimeve sociale nga shteti te ofruesit e pavarur, duhen marrë në konsideratë këto tre karakteristika. Kjo do të nënkuptonte që sistemi për prokurimin social duhet:

- a. Të mos bazohet në çmimin më të ulët të ofruar por në kapacitetin e ofruesve, cilësinë e shërbimeve që ata mund të ofrojnë dhe në vizionin e tyre afat-gjatë për zhvillimin e shërbimeve apo adresimin e problemeve sociale;
- b. Të mundësojë kontrata afat-gjata në vend të tenderave që realizohen vetëm një herë. Kontratat afatgjata garantojnë qëndrueshmërinë e ofruesve dhe sigurojnë që ata të investojnë në zhvillimin e tyre dhe në zhvillimin e shërbimeve që ofrojnë;
- c. Të jetë fleksibël dhe të lejojë ofruesit e shërbimeve të investojnë në mënyrën më të mirë burimet që ata marrin. Kjo do të thotë gjithashtu edhe marrje të pagesave në kohë dhe avancë (në vend të bazimit në parimin e kompensimit të shpenzimeve të kryera);
- d. Të lejojë konkurrencën.

Siç vërehet më sipër, ka metoda të ndryshme të cilat përdoren për transferimin e ofrimit të shërbimeve sociale tek ofruesit e pavarur. Secila prej tyre ka pika të dobëta e të forta. Ndërkohë që prokurimi është mekanizmi më tipik i përdorur nga shteti për të blerë shërbime, ky mund të mos jetë mekanizmi më i përshtatshëm për të blerë shërbimet sociale pasi faktori kryesor për përzgjedhjen e një ofruesi duhet të jetë kapaciteti i ofruesit. Për më tepër, shumë shpesh shtetet prezantojnë çmime fikse për mbulimin e kostove për disa shërbime sociale në mënyrë që të mos ketë konkurrencë në çmime. Disa vende kanë zhvilluar procedura të ndara për prokurimin e shërbimeve sociale ku procedura është më e thjeshtë dhe kriteret e përzgjedhjes janë të lidhura ngushtësisht me kapacitetin e ofruesit dhe programin e propozuar për zhvillimin e shërbimit (një shembull është Bullgaria).

Nga ana tjetër, grantet janë një mekanizëm shumë i mirë për të zhvilluar projekte pilot ose prezantuar shërbime të reja dhe novatore. Grantet janë të rëndësishme gjithashtu për rritjen e kapaciteteve të ofruesve.

Zgjedhja e ofruesit nga klientët duket tunduese, por ky sistem është i vështirë për t'u krijuar sepse ai është i mundur vetëm kur tregu i shërbimeve sociale është i zhvilluar mirë dhe ka ofrues të ndryshëm të cilët mund të vazhdojnë të ekzistojnë edhe nëse ata nuk kanë buxhet të garantuar.

3.6. Cili është një kuadër që mbështet prokurimin social nga OSHCtë?

Ka masa të ndryshme përmes të cilave qeveritë mund të mbështesin transferimin e ofrimit të shërbimeve sociale nga qeveria tek OSHCtë. Hapi i parë është që **OSHCtë lejohen të ofrojnë shërbime në fushat ku kontraktimi do të realizohet** – zakonisht këto fusha përfshijnë fushën sociale, edukimin dhe kujdesin shëndetësor. OSHCtë duhet gjithashtu të mos bëhen subjekt i kërkesave administrative shtesë të cilat nuk ekzistojnë për ofrues të tjerë dhe, edhe nëse ka kërkesa specifike regjistrimi për ofruesit e shërbimeve, ato nuk duhet të jenë shumë të rënduara.

Një faktor i dytë i rëndësishëm lidhet me **ekzistencën e fondeve për kontraktimin e shërbimeve, këto fonde janë të parashikueshme dhe OSHCtë mund t'i përfitojnë ato**. Për më tepër, duke qenë se shërbimet sociale kërkojnë angazhim afat-gjatë, ka gjithashtu mundësi për financim afat-gjatë dhe kontrata afat-gjata për ofrimin e shërbimeve sociale. Nëse ofruesi ndërrohet çdo vit, nuk ka interes për të investuar në përmirësimin e shërbimit apo të bëjë përpjekje të tjera për trajtimin e përfituesve (duke qenë se kjo nuk do të ndikonte në faktin që vitin tjetër do të kishte një tender të ri). Është gjithashtu e rëndësishme që financimi të jetë fleksibël dhe të mos ketë vonesa në pagesa. Financimi duhet të mundësojë gjithashtu mbulimin e kostove administrative të ofruesve.

Një faktor i tretë i rëndësishëm është **ekzistenca e procedurave të thjeshta dhe transparente përmes të cilave zgjidhen ofruesit e shërbimeve dhe OSHCtë janë në gjendje të marrin pjesë në tenderë**. Është shumë e rëndësishme që procedura të tilla të marrin në konsideratë karakterin specifik të shërbimeve sociale dhe të bazohen në kapacitetin e ofruesit dhe jo vetëm në çmim.

Së fundi, është shumë e rëndësishme që **OSHCtë të përfshihen në të gjitha fazat e ciklit të shërbimit** – të marrin pjesë në përcaktimin e politikave sociale, në vlerësimin e nevojave, në

përcaktimin se si të përmbushin sa më mirë këto nevoja, në ofrimin e shërbimeve si edhe në monitorim e vlerësim.

3.7. Cilat janë përfitimet e kontraktimit social?

Arsyet që qeveria të kontraktojë shërbime tek ofruesit e pavarur:

- Nëse një shërbim kontraktohet, qeveria mund të fokusohet në funksionet e saj kryesore – politikëbërje dhe monitorim të zbatimit të politikave. Gjithashtu, asaj nuk i duhet të merret me probleme të tilla si gatimi për personat e varfër, etj. Përmes kontraktimit, kapaciteti i limituar njerëzor i qeverisë, do t'i përkushtohet funksioneve kryesore;
- Qeveria gjithashtu do të jetë e aftë të ushtrojë më tepër kontroll mbi shërbimet e ofruara dhe do të fokusohet në kujdesin ndaj përfituesve, jo në kënaqësinë e stafit që punon për shërbimet;
- Shumë shpesh ka një presion ndaj qeverisë për uljen e numrit të punonjësve të punësuar (punonjësit e shtetit). Transferimi i detyrimeve tek ofruesit e jashtëm është një mënyrë kyçe për të adresuar këtë.
- E fundit, por jo më pak e rëndësishmja, një arsye për transferimin e ofrimit të shërbimeve tek ofruesit e jashtëm është rritja e cilësisë së shërbimeve ose arritja e një grupi më të madh e njerëzve në nevojë.

Përfitimet e ofrimit të shërbimeve nga OSHCtë:

- OSHCtë punojnë për përmirësimin e jetës së grupeve të pa avantazhuara dhe është në misionin e tyre ofrimi i shërbimeve sociale tek ta. Kjo siguron që ata të shprehin interes në ofrimin e shërbimeve cilësore dhe jo thjesht interes në marrjen e fondit.
- OSHCtë kanë njohuri më të mira për nevojat e klientëve dhe kanë ekspertizën e nevojshme për të ofruar shërbime.
- OSHCtë janë në gjendje të tërheqin burime të tjera (përmes punës vullnetare, dhurimeve, financimit të projekteve, etj.) dhe të maksimizojnë efektin e fondeve të shpenzuara nga qeveria. Përmes financimeve shtesë ato mund të rrisin cilësinë e shërbimit ose të mbulojnë më tepër përfitues.
- OSHCtë janë më fleksibël në mënyrën se si ato veprojnë – ato mund të përdorin staf me kohë të pjesshme (në vend që të hapin një pozicion me kohë të plotë), reagojnë ndaj emergjencave, etj.
- OSHCtë sjellin risi në fushën sociale. Ato mund të pilotojnë shërbime e metoda të reja, ato mund të aksesojnë praktikat më të mira ndërkombëtare (përmes partnerëve që kanë jashtë vendit) dhe shumë nga shërbimet sociale të prezantuara së fundmi në shumë sisteme janë prezantuar në fakt nga OSHCtë.
- Shumë shpesh, vetë OSHCtë përfaqësojnë njerëz, gjë që i jep besueshmëri politikës lokale.

IV. SHËMBUJ NDËRKOMBËTAR RRETH FUNKSIONIMIT TË PROKURIMIT SOCIAL

4.1. Modele vendesh

Ekzistojnë modele të ndryshme për ofrimin e shërbimeve sociale. Këto shkojnë nga sistemet ku kontraktimi social është në fazat e para të zhvillimit deri tek sisteme të komplikuar të cilat përdorin mekanizma të ndryshëm për të transferuar ofrimin e shërbimeve tek OSHCtë. Një

shembull i një vendi që është në fazat e para të zhvillimit është Armenia ku qeveria ofron kryesisht mbështetje materiale dhe pagesa të drejtpërdrejta për personat në nevojë. Shërbimet sociale ofrohen kryesisht nga OSHCtë me financim nga donatorët. Megjithatë, qeveria ka vendosur të mbështesë disa nga OSHCtë që ofrojnë shërbime sociale duke i përfshirë ato në buxhetin vjetor dhe ato marrin buxhetin financim të drejtpërdrejtë pa konkurs. Në këtë rast, burimet e shtetit mbulojnë një pjesë të vogël të kostos së ofrimit të shërbimeve sociale dhe organizatave iu duhet të sigurojnë vetë pjesën tjetër. Nuk ka mekanizëm të prokurimit social.

Bullgaria përfaqëson një tjetër model. Shteti ka prezantuar një mekanizëm të veçantë (nga prokurimi publik) përmes të cilit zgjidhen ofruesit e shërbimeve sociale për të cilat shteti ka detyrimet. Ato përzgjidhen nëpërmjet një tenderi të organizuar në nivel lokal (nga kryetari i bashkisë). Si OSHCtë ashtu edhe kompanitë tregtare mund të marrin pjesë por praktika tregon se në më shumë se 90% të rasteve janë OSHCtë ato që zgjidhen si ofrues të shërbimeve sociale. Aktualisht më tepër se 10 mln. EUR shpërndahen midis OSHCve përmes këtij mekanizmi dhe rreth 20% e të gjitha shërbimeve të financuara nga shteti i kontraktohen OSHCve (vetëm 10 vjet pas prezantimit për herë të parë të këtij mekanizmi). Më e rëndësishmja, në procedurën e tenderimit, çmimi nuk është në kriteret e përzgjedhjes (duke qenë se buxheti për shërbimet është pjesë e informacionit të shpallur që në fillim të konkursit). OSHCtë konkurrojnë bazuar në eksperiencën dhe në programin e tyre për ofrimin e shërbimeve që do të kontraktohen.

Hungaria përfaqëson një tjetër model të transferimit të ofrimit të shërbimeve tek OSHCtë. Mekanizmi më i zakonshëm i përdorur për të përzgjedhur ofruesit e shërbimeve sociale quhet mbështetje normative. Në këtë rast është klienti që zgjedh ofruesin, dhe jo shteti. Shteti zgjedh një grup më të gjerë ofruesish të cilët janë të autorizuar të ofrojnë shërbimet përkatëse për të cilat qeveria do të paguajë. Pastaj përfituesit që përdorin shërbimet sociale të financuara nga shteti lejohen të zgjedhin se cilin ofrues ata preferojnë dhe shteti kompenson ofruesin për shërbimet që klientët përdorin.

Holanda përdor një sistem social më të komplikuar ku shumë nga kostot për shërbime të caktuara (p.sh. shërbimet për persona me aftësi të kufizuara) mbulojnë nga sigurimi shëndetësor. Përzgjedhja paraprake e ofruesve të shërbimit bëhet në nivel rajonal nga kompanitë e sigurimeve që kanë më tepër klientë në rajonin përkatës. Ajo firmos kontrata me këto ofrues dhe i ofron atyre financime bazuar në numrin e klientëve që ata kanë. Përsëri, zgjedhja se cili nga ofruesit e zgjedhur paraprakisht do të kujdeset për secilin klient është e vetë klientit (kështu përzgjedhja e fundit bëhet nga klienti/përfituesi). Përveç kësaj, Holanda lejon që klienti, në vend që të marrë shërbimet që i janë akorduar, mund të marrë ekuivalentin financiar të 75% të kostos së këtyre shërbimeve (buxhet individual). Përveç kësaj skeme të buxhetit personal, për shërbime të tjera mund të ketë konkurrim për përzgjedhjen e ofruesve në nivel bashkie. Bashki të ndryshme zgjedhin lloje të ndryshme procedurash kontraktimi p.sh. konkurrim bazuar si në çmim ashtu edhe në cilësi; ose çmim i përcaktuar dhe konkurrim vetëm për cilësinë; ose bërja e fazës së parë ku ofruesit kualifikohen bazuar në eksperiencën dhe cilësinë e shërbimeve që ata do të ofrojnë, i ndjekur më pas nga një konkurrim mbi çmimin mes ofruesve të para-zgjedhur, etj.

Një shembull interesant ekziston në Poloni ku është e mundur që OSHCtë të ofrojnë një ofertë për ofrimin e shërbimit social edhe në rastin kur ai ofrohet aktualisht nga agjencitë shtetërore. OSHCja duhet të prezantojë një ofertë dhe autoriteti përkatës publik duhet që brenda një muaji ta vlerësojë atë dhe të vendosë nëse do të hapë një tender për shërbimin në fjalë.

Në Mbretërinë e Bashkuar transferimi i ofrimit të shërbimeve tek OSHCtë ka një traditë të vjetër. Disa nga trendët e rinj që kanë të bëjnë me kontraktimin social kanë pasur një efekt të paqartë tek OSHCtë që ofrojnë shërbime sociale. Duke fokusuar sistemin social tek rezultatet, në Mbretërinë e Bashkuar po prezantohet një sistem “pagese sipas rezultateve”. Ndërkohë që synimi i tij është pozitiv, sepse arritja e rezultatit përmes financimit është e rëndësishme, kjo nënkupton që shumë OSHC nuk janë në gjendje të konkurrojnë për financim pasi ato nuk kanë burime të mjaftueshme për të mbuluar paraprakisht kostot të cilat më pas kompesohen bazuar në rezultate.

Një tjetër model interesant, që gjithashtu mund të ketë një efekt negativ tek OSHCtë, është modeli i agjencisë kryesore ose “kontraktori kryesor”. Në këtë rast, shteti në vend që të kontraktojë disa ofrues për shërbime të ndryshme që ka për të ofruar, unifikon kontratat e vogla në një më të madhe dhe përzgjedh një “kontraktor kryesor” – një ofrues i madh i cili mundet më pas të nënkontraktojë shërbimet e vogla tek ofruesit më të vegjël. Në këtë rast shteti ka më pak ngarkesë sepse në vend që të administrojë shumë kontrakte, ai kujdeset vetëm për një kontraktim të madh. Në një rast të tillë, atij nuk i duhet të shqetësohet nëse procedura është e shumë e ngarkuar apo shumë burokratike, sepse kompania e madhe, me eksperiencë, merret me këtë gjë. Nga ana tjetër, nuk është e qartë se si kontraktori kryesor përzgjedh të nënkontraktuarit e tij dhe nëse do të ketë OSHC mes tyre. Sigurisht, rritja e masës së kontrakteve ul numrin e OSHCve që mundën në fakt të konkurrojnë për to, gjë që kufizon konkurrimin dhe mundet që ndonjëherë të ndikojë në cilësinë e shërbimeve të ofruara.

4.2. Rregullorja e BEsë

Ka një udhëzim të BEsë mbi prokurimin publik², i cili lejon disa përjashtime nga rregullorja e prokurimit të përgjithshëm në rastin e shërbimeve shëndetësore apo sociale. Për ta nuk është i rëndësishëm përdorimi i mekanizmit të prokurimit publik, por përdorimi i një mekanizmi tjetër që reflekton më mirë kushtet specifike që lidhen me këto shërbime. Gjithsesi, nëse vlera e kontratave të tilla tejkalon një limit minimal, procedura të paktën duhet të sigurojë që është transparente dhe që të gjithë operatorët ekonomikë trajtohen në mënyrë të barabartë³.

Me fjalë të tjera, BE lejon që shërbimet sociale të kontraktohen jo duke përdorur mekanizmin e prokurimit publik, por duke dizenuar një mekanizëm të veçantë që mund të jetë më i thjeshtë dhe që merr në konsideratë specifikat e shërbimeve sociale dhe ofruesit potencialë të tyre.

V. MJEDISI LIGJOR PËR KONTRAKTIMIN E SHËRBIMEVE SOCIALE TE OSHC-TË NË SHQIPËRI

5.1. Mundësitë e OSHCve për t’u përfshirë në aktivitet ekonomik

Bazuar në Ligjin mbi Organizatat Jo Fitimprurëse⁴, organizatat mund të ushtrojnë aktivitet ekonomik (neni 36). Për këtë nuk është e nevojshme që organizatat të krijojnë një entitet

² DIRECTIVE 2014/24/EU OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL 26 February 2014 on public procurement and repealing Directive 2004/18/EC

³ Directive 2014/24/EU, paragrafi 114 (faqe 23). Pragu I vendosur sipas nenit 4 të Direktivës është 750 000 EUR.

⁴ Ligj Nr. 8788 date 7 Maj 2001, mbi Organizatat Jo-fitimprurëse

ligjor më vete. Kjo do të thotë që ato mund të krijojnë të ardhura nga kontratat e shërbimit ose prokurimi publik.

5.2. Ofrimi i shërbimeve sociale (bazuar në rishikimin e Ligjit Nr.9335/10.03.2005 për ndihmën dhe shërbimet shoqërore)

Ligji përcakton që ka shërbime sociale publike e private (neni 17). Publike janë ato shërbime të cilat financohen nga shteti apo pushteti vendor, ndërsa private janë shërbimet e financuara nga burime private. Ligji gjithashtu parashikon liçensimin e të gjithë ofruesve si dhe që, për të gjitha shërbimet mund të kontraktohen subjekte private bazuar në Ligjin për prokurimin publik. (neni 18).

Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë (MMSR) është përgjegjëse për politikën shtetërore në fushën e çështjeve sociale përfshirë planifikimin e fondeve. Ajo vendos gjithashtu standartet për shërbimet dhe monitoron ofrimin e tyre në nivel kombëtar dhe vendor, si për ofruesit shtetërore ashtu edhe për ata privatë (neni 27). MMSR gjithashtu harton kërkesa për fonde dhe i paraqet ato pranë Ministrisë së Financave (neni 28). Financimi bëhet në varësi të mundësive të buxhetit të shtetit (neni 32).

Në nivel vendor, këshilli bashkiak mes të tjerash (neni 29):

- Aprovon fondet për shërbimet sociale;
- Harton një plan për zhvillimin e shërbimeve sociale;
- Aprovon dhe mbështet zhvillimin e shërbimeve sociale bazuar në nevojat vendore;
- Autorizon njësitë e qeverisjes vendore për të kontraktuar ofruesit.

Fondet shtetërore për shërbime sociale transferohen nga MMSR tek autoritetet vendore në fillim të çdo viti (neni 38). Metodologjia e llogaritjes dhe alokimi bëhet nga MMSR dhe Ministria e Financave dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Përveç kësaj, ka edhe burime të tjera të fondeve shtetërore për shërbime sociale, si p.sh. Lotaria Kombëtare⁵ e cila përcakton se një kontribut i detyrueshëm prej 2,2% i xhiros vjetore të të liçensuarit duhet të dedikohet për "çështje të mira". Përzgjedhja e projekteve, organizatave apo aktiviteteve që do të përfitojnë nga ky fond do të bëhet nga Bordi për Çështje të Mira që do krijohet me një vendim të Këshillit të Ministrave. Bordi do të përbëhet nga 4 përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe tre përfaqësues të të liçensuarit. Bordi do të marrë vendimet në bazë të procedurave dhe kritereve të përcaktuara me vendim të Këshillave të Ministrave dhe një udhëzim që do të lëshohet nga Ministri i Financave⁶.

Një burim tjetër i financimit vjen nga zbatimi i Ligjit "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë"⁷. Ligji krijon një Fond të Posaçëm për Parandalimin e Kriminalitetit (neni 37), me të ardhurat që vijnë nga zbatimi i tij, për të mbështetur shërbimet që lidhen me nevojat e grupeve të

⁵ Ligj nr. 95/2013 Për Miratimin e Marrëveshjes së Licencës për Lotarinë Kombëtare ndërmjet Ministrisë së Financave, si autoritet i autorizuar dhe shoqërisë "OESTERREICHISCHE LOTTERIEN", GMBH, nëpërmjet "OLG PROJECT" SHPK,

⁶ Idem, 18.3, pika c.

Ligj nr. 10 192, dt. 3.12.2009 (ndryshuar me ligjin nr.24/2014)

⁷ Ligj nr. 10 192, dt. 3.12.2009 (ndryshuar me ligjin nr.24/2014)

prekura apo të rrezikuara nga krimi. Përveç autoriteteve publike në nivel qendror e vendor, përfitues të këtij fondi nëpërmjet financimit të projekteve për parandalimin e kriminalitetit, janë gjithashtu edhe OSHCtë (neni 37, Pika 2, b). Duke qenë se krijimi i këtij fondi bazohet në të ardhurat, ai nuk është një fond i qëndrueshëm dhe i parashikueshëm çdo vit. Nga ana tjetër, nuk ka rregulla dhe procedura të qarta për shpalljen e fondit dhe procesi i aplikimit nuk shpallet publikisht.

5.3.Procedura për prokurimin e shërbimeve (bazuar në një rishikim të Ligjit për prokurimet publike nr 9643 / 20.11.2006 ndryshuar me ligjin nr. 131/2012)

5.3.1. Procedurat e aplikueshme

Ndërsa ka një ligj të veçantë për Koncesionet dhe Partneritetin Publik-Privat⁸ ku shërbimet sociale janë një nga fushat që mund të ofrohen si koncesione, ky mekanizëm nuk është me të vërtetë i zbatueshëm për kontraktimit social. Kjo për shkak se qëllimi i ligjit është që të përdoren burimet private për të investuar në vepra dhe shërbime të caktuara dhe kompensimi për këto do të "rrjedhë nga e drejta për të shfrytëzuar veprat apo shërbimet që janë objekt i koncesionit p.sh. "për të gjeneruar të ardhura ". Kjo do të thotë se investitori privat pritet të ngarkojë një tarifë për përdorimin e punëve ose shërbimeve përkatëse. Në rastin e shërbimeve sociale klientët e të cilave janë zakonisht njerëzit me burime të pamjaftueshme financiare (që të jetë në gjendje për të paguar për shërbimet e marra), mekanizmi i koncesioneve nuk është një opsion.

Siç është përmendur më sipër, kontraktimi i shërbimeve të ofruesit privatë kryhet sipas rregullave dhe procedurave të Ligjit për Prokurim Publik. Ligji i prokurimit publik përjashton nga objekti i tij disa lloje të shërbimeve, por jo specifikisht shërbimet sociale. Një nga zonat e përjashtuara është kërkimi dhe zhvillimi i shërbimeve (neni. 7 / d). Në rastet e shërbimeve të kujdesit social, nëse autoriteti kontraktues nuk ka një projekt për shërbimin që do të prokurohet, mund të zgjidhë si procedurë prokurimi "shërbimin e konsulencës", e cila ofron shërbimet e një natyre intelektuale dhe këshillimi⁹. Cdo autoritet kontraktues është i detyruar që të krijojë një njësi prokurimi e cila organizon procedurat e prokurimit. Ligji përcakton pragun specifik mbi bazën e të cilit zgjidhet procedura e prokurimit. Është e mundur që të përdoret një procedurë e thjeshtëzuar vetëm nëse vlera e kontratës është nën kufirin e ulët: 400 000 lekë. Nëse vlera e kontratës vlerësohet mbi pragun e ulët, përveç procedurës së hapur mund të organizohet një procedurë e kufizuar. Kjo është një procedurë, sipas së cilës autoriteti kontraktues fillimisht vlerëson kapacitetin e kandidatëve dhe fton vetëm kandidatët me kapacitetet e nevojshme për të paraqitur një ofertë.

5.3.2. Kriteret e vlerësimit

Sa i përket vlerësimit të ofertave, ekziston një mundësi që t'u kërkohet kandidatëve të listojnë edhe stafin e tyre (neni 44). Kjo është e rëndësishme në aspektin e ofrimit të shërbimeve sociale, ku kualifikimet e profesionistëve që do të punësohen për të ofruar shërbimet, janë shumë të rëndësishme për cilësinë e ofrimit të shërbimit.

⁸ Ligj nr. 125.2013 Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik-Privat

⁹ Udhëzimi Nr. 06 date 03.09.2013 Për zhvillimin e Procedurave të Prokurimit për Shërbimet e Përkujdesjes Shoqërore

Zakonisht, kriteri më i përdorur i vlerësimit në procedurat e prokurimit publik është "oferta më e ulët ". Për kontraktimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, bazuar në Udhëzimin e Agjencisë së Prokurimit Publik¹⁰, autoriteti kontraktor mund të përdorë "ofertën ekonomike më të favorshme" kur ajo gjykohet si më e përshtatshme. Por, edhe në këtë rast, pesha e çmimit në procesin e vlerësimit nuk duhet të jetë më pak se 50 pikë (50% e pikëve të vlerësimit).

Autoriteti kontraktues mund të përdorë kritere të ndryshme vlerësimi, përveç çmimit (neni 55). Nëse vendos të përdorë kritere të tilla të tjera, ai duhet të sigurojë që:

- Kërkesat për kandidatët janë të lidhura me lëndën e kontratës;
- Ato janë objektive, proporcionale dhe jodiskriminuese;
- Kriteret janë vendosur në mënyrë të qartë në njoftimin e tenderit;
- Ato janë vendosur në një mënyrë të tillë që ato të mund të vlerësohen në sasi ose cilësi dhe mund shprehen në terma monetare ose sipas kriterit kalon / dështon.

Duke konsideruar natyrën e vecantë të shërbimeve sociale, njësia e prokurimit si pjesë e kritereve specifike, duhet të kërkojë licensën dhe standartet e shërbimeve¹¹.

¹⁰ Idem

¹¹ Idem

VI. PRAKTIKA LIDHUR ME KONTRAKTIMIN E SHËRBIMEVE SOCIALE TE OSHC-të

Ligji “Për ndihmën dhe shërbimet sociale” është miratuar në vitin 2005. Gati 10 vjet pas miratimit të tij, nuk ka pothuajse asnjë praktikë të sigurimit të fondeve nga Njësitë e Qeverisjes Vendore (NJQV) të OSHCtë për ofrimin e shërbimeve sociale, sipas procedurës së përcaktuar në ligj - duke përdorur mekanizmat e prokurimit publik. Rastet e ralla ekzistuese janë sporadike, psh. Fondacioni Misioni Emanuel në Korçë, që ka marrë dy kontrata nga Bashkia e Korçës gjatë vitin 2014.

Gjatë këtyre 8 viteve, Bashkia e Vlorës nuk ka patur asnjë eksperiencë të procedurave të tenderimit të drejtpërdrejtë të shërbimeve sociale. Është e vështirë të prokurohen shërbimet sociale sepse këto shërbime sigurojnë jo vetëm materiale, por edhe mbështetje morale dhe përfitime, kështu që shërbimi nuk mund të matet.

Nënkryetari i Bashkisë së Vlorës

Bazuar në takimet dhe fokus – grupet e organizuara në Tiranë, Vlorë, Durrës, Korçë dhe Shkodër, mund të identifikojmë një seri problemesh që pengojnë zhvillimin e procesit të kontraktimit social dhe sigurimit të shërbimit social në përgjithësi.

a. Mungesa e traditës për të ofruar shërbime sociale me bazë komunitare.

Politika sociale në Shqipëri është përqëndruar në 3 fusha kryesore:

- Ndihma ekonomike (pagesat në para);
- Pagesa në para për personat me aftësi të kufizuara;
- Mbështetje për institucionet rezidenciale.

Edhe pse ligji përcakton tipe të ndryshme shërbimesh sociale, përfshirë ato me bazë komunitare, në praktikë shërbimet më të zhvilluara në Shqipëri janë shërbimet sociale rezidenciale. Institucionet përmes të cilave këto shërbime ofrohen janë krijuar dhe ushtrojnë veprimtarinë nga qeveria (shumë institucione kanë kaluar nën përgjegjësinë e autoriteteve vendore) kështu që nuk ka ndodhur dhe nuk ka planifikim për kontraktim. Aktualisht qeveria është e angazhuar në reformën e përkujdesit social dhe një nga qëllimet e saj është reformimi gradual i institucioneve dhe zhvillimi i shërbimeve alternative. OSHC-të janë të vetmet që ofrojnë shërbime sociale me bazë komunitare.

Qendra komunitare “Sot për të Ardhmen” në Durrës mbështetet nga Bashkia e Durrësit për ofrimin e dy shërbimeve 1) Mbështetje ligjore dhe psikologjike, dhe 2) Linjë këshillimi për viktimat e dhunës në familje. Mbështetja nisi përmes një projekti të UNDP gjatë vitit 2010, ku qendra komunitare “Sot për të Ardhmen” u përzgjedh midis OSHC-ve që aplikuan me projektet e tyre, pas njoftimit të bërë nga Bashkia (jo përmes një procedure të prokurimit publik). Pas përfundimit të projektit të UNDP, Bashkia ka vazhduar të mbështesë qendrën, por nuk ka një mekanizëm rregullues që siguron financim të drejtpërdrejtë për qendrën. Vetë bashkia kryen pagesa të drejtpërdrejta ndaj ofruesve të tjerë të shërbimeve për shërbimet dhe aktivitetet që ofrohen në qendrën komunitare.

b. Mungesa e fondeve publike për shërbimet sociale

Buxheti i shtetit siguron fonde që mbulojnë vetëm tre llojet kryesore të shërbimeve sociale. Një pjesë e këtyre fondeve janë transferuar tek autoritetet lokale për menaxhimin e institucioneve rezidenciale që janë nën kontrollin e tyre. Si në buxhetin e shtetit ashtu edhe në atë lokal mungon një zë i veçantë për shërbimet sociale. Shërbimet sociale përfshihen nën zërin e “shërbimeve” dhe pavarësisht shumëllojshmërisë së shërbimeve sociale të ofruara kryesisht nga OSHCtë, fondi shkon vetëm tek shërbimet tradicionale të ofruara përmes institucioneve publike, dhe asnjë fond nuk i dedikohet shërbimeve të reja.

Të gjitha shërbimet sociale janë bërë pjesë e detyrimeve të autoriteteve lokale. Dhe të gjitha shërbimet sociale të financuara nga buxheti i shtetit apo lokal duhet të prokurohen nga njësitë e qeverisjes vendore për ofruesit privatë sipas ligjit të prokurimit publik. Gjithsesi, transferimi i detyrimeve nuk ka rezultuar në rritje të buxhetit dhe të gjitha shërbimet sociale me bazë komunitare duhet të sigurohen nga burimet e veta të NJQVve.

Ne përfituam nga granti i Bankës Botërore në 2008, por kur fondi përfundoi, gjërat u vështirësuan dhe gjithë mbështetja për OSHC-të që ofronin shërbime sociale dhe që përfitonin nga granti, përfundoi aty.

Qendra “Fëmija dhe Nëna në Fokus”, Vlorë

Një shembull për problemin serioz me të cilin NJQVtë ndeshen kur përpiqen të sigurojnë fonde, është rasti i projektit të Bankës Botërore në vitin 2005 në bashkëpunim me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta që financuan krijimin e qendrave komunitare për të ofruar shërbime sociale për grupet e marxhinalizuara në bashkitë e Shkodrës, Durrësit, Vlorës dhe Tiranës, por pas përfundimit të projektit dhe fondit të Bankës Botërore, vetëm Qendra për Gratë dhe Fëmijët - Kombinat në

Tiranë vazhdoi të merrte mbështetje dhe fonde nga bashkia e Tiranës për një periudhë 5 – vjecare përmes një kontrate të nënshkruar me bashkinë dhe aprovimit të Këshillit Bashkiak. Gjatë 2012, me ndryshimin e forcës politike në pushtet u ndërpre dhe mbështetja dhe fondi nga bashkia.

Në praktikë, shumica e eksperiencave të kontraktimit apo tentativave për të kontraktuar OSHC-të për të ofruar shërbime sociale ka nisur apo ka qenë rezultat i projekteve të mbështetura nga donatorë të huaj, siç është rasti i Bankës Botërore, UNDP, Cooperacione Decentrata Emiglia Romana Region, Bashkimi Evropian, etj. Dhe të gjitha rastet tregojnë se në përfundim të projektit, përfundon dhe mbështetja e shtetit.

c. Mungesa e procedurave të përshtatshme për kontraktimin social

Ligji i prokurimit publik është fleksibël në aspektin e përcaktimit të procedurës, në kërkesën për eksperiencë të mëparshme në fushën e shërbimit për t’u kontraktuar apo në lidhje me kapacitetin financiar të kandidatëve. Por, një çështje që është e pashmangshme, është pesha e ofertës financiare në vlerësimin e kontraktorëve potencialë. Edhe në qoftë se zgjidhet oferta ekonomikisht më e vlefshme si një metodë për zgjedhjen e fituesit (në krahasim me çmimin më të ulët), çmimi duhet të vazhdojë të jetë së paku 50% e vlerësimit total. Ky është një problem i identifikuar nga aktorë të ndryshëm sepse në fushën sociale cilësia e shërbimeve është faktori më i rëndësishëm.

OSHC-të e kanë të vështirë të konkurrojnë me bizneset e mëdha për procedurat e prokurimit, sepse përzgjedhja e ofertës me çmimin më të ulët mbetet kriteri kryesor.

SEEP, Vlora

Ka patur përpjekje nga MMSR për të kontraktuar apo siguruar financime për operatorët privatë të shërbimeve sociale, por për shkak të procedurave të

17

komplikuara, këto përpjekje kanë dështuar. P.sh. Ministria u përpoq të mbështesë qendrat anti-trafik për të mbuluar kostot e ushqimit, por procesi paraqiste vështirësi për kandidatët dhe si përfundim dështoi.

Mungesa e procedurave të qarta shoqëruar me mungesën e kuptueshmërisë së procedurave si nga autoritetet lokale ashtu edhe OSHC-të ka krijuar disa situata sipas së cilave kontratat dhe marrëveshjet e bashkëpunimit janë konsideruar të parregullta nga inspektorët e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe bashkitë janë dënuar për praktikën që ato kanë ndjekur, siç është rasti i bashkisë së Shkodrës dhe Korçës. Duke marrë në konsideratë këtë eksperiencë “të keqe” në Bashkinë e Shkodrës edhe pse për tre vite me rradhë fondi mbi shërbimet sociale është rritur si rezultat i lobimit me Këshillin Bashkiak, fondi nuk është përdorur. Pavarësisht dëshirës dhe përpjekjes, bashkia ka dështuar për të gjetur mekanizmat e nevojshme apo procedurat për të transferuar apo prokuruar këtë fond tek organizatat e specializuara në Shkodër.

Ligji ekzistues i Prokurimit Publik nuk mundëson prokurimin nga OSHC-të, rregullat e prokurimit publik nuk janë të qarta dhe decentralizimi fiskal i NjQVve është ende i paqartë, duke lënë hapësira për këndvështrime të ndryshme dhe si rezultat praktika të ndryshme.

Bashkia Shkodër

Është më e lehtë për bashkinë të paguajë një këngëtar për një koncert sesa të mbështesë një shërbim social në një komunitet në nevojë, jo sepse nuk ka vullnet, por për shkak të mungesës së procedurave, dhe procedurat e prokurimit publik ekzistues janë shumë të ngurta për të prokuruar shërbimet sociale.

Aulona, Vlorë

d. Mungesa e kapaciteteve për të kontraktuar shërbimet sociale

Një faktor i rëndësishëm që pengon procesin është mungesa e kuptimit të rëndësisë së kontraktimit të shërbimeve sociale. Shumë shpesh bashkitë nuk janë të familjarizuara me këtë mundësi, nuk dinë nëse është e lejueshme dhe si ta realizojnë në praktikë një procedurë të tillë. Mungesa e shembujve dhe praktikave të mira është një faktor i rëndësishëm për të tjerët për të mos identifikuar përjasje inovative. Nga ana tjetër, OSHC-të nuk janë të ndërgjegjësuar për mundësitë ekzistuese dhe nuk kanë advokuar aktivisht për një ndryshim të situatës në lidhje me kontraktimin social.

Si shtet Shqipëria nuk mund të ketë prokurim social sepse mungojnë kapacitetet e duhura, financiare dhe njerëzore, të paktën kur flitet në nivel lokal.

Nën kryetari i Bashkisë Vlorë

e. Vonesat dhe problemet e tjera që lidhen me pagesat

Në rastet e rralla të identifikuar, ku OSHC-të kanë përfituar fonde publike për të ofruar shërbime sociale dhe shërbime të tjera, përmenden probleme lidhur me pagesat, duke e vështirësuar zbatimin dhe ofrimin e shërbimit të kërkuar nga OSHC-të. Probleme të tjera lidhen me:

- Vonesa në pagesa dhe mungesa e pagesës për shërbimin e kryer.
- Rimbursimi pasi shërbimi është kryer.
- Detyrimi për t'i dorëzuar autoriteti kontraktues një sigurim kontrate në masën 10% të vlerës së kontratës para firmosjes së saj.¹²

Deri tani, ofruesit e shërbimeve kanë qënë të prekur edhe nga fakti që çmimi i shërbimeve sociale përfshinte edhe TVSH, por disa ndryshime pozitive janë bërë në Ligjin e TVSH¹³, në të cilin shërbimet dhe të mirat që lidhen me përkujdesin dhe asistencën sociale, ofruar nga institucionet publike dhe organizatat jofitimprurëse janë përfshirë nga TVSH.

Gjatë vitit 2012 me një kërkesë nga bashkia e Kavajës ne jemi kontraktuar për të ofruar shërbime psiko-sociale për qendrën e të moshuarve dhe ende nuk kemi marrë pagesën përfundimtare. Bashkia po pret të mbledhë para nga taksapaguesit për të kryer pagesën.

CSDC, Durrës

f. OSHC-të shihen si një burim dhe jo përfitues të fondeve

Ndërkohë që OSHC-të konsiderohen si partnerë kyç të qeverisë në fushën sociale, roli i tyre shihet më tepër si një mekanizëm për të tërhequr fonde donatorësh në pjesë të ndryshme të vendit dhe për të mbështetur financiarisht autoritetet lokale për zgjidhjen e problemeve serioze sociale. Ato nuk shihen seriozisht si përfituese të fondeve të shtetit/bashkisë për ofrimin e shërbimeve sociale. Edhe në rastet kur OSHC-të kanë përfituar fonde të tilla, kanë qënë afatshkurtra dhe mbi baza projektsh.

Pavarësisht gjithë këtyre mangësive, situata aktuale ofron një mundësi të madhe për të nxitur kontraktimin social. Në Shqipëri, ndryshe nga vendet e tjera të rajonit, pikërisht për shkak se shteti deri më tani nuk e ka mbështetur zhvillimin e shërbimeve sociale me bazë komunitare, çështja e humbjes së vendit të punës nga punonjësit e shtetit që punojnë në fushën e shërbimeve sociale, nëse shërbimet kontraktohen te ofruesit privatë, nuk është problem. Në shumë vende kjo është një pengesë e rëndësishme për procesin e kontraktimit social. Përveç kësaj, mjedisi politik dhe faza e reformave në vetvete paraqesin një mundësi:

1. Reforma e përkujdesit social është në proces- qëllimi i saj, ndër të tjera, do të jetë identifikimi i mundësive për zhvillimin e shërbimeve sociale me bazë komunitare dhe mënyrat sesi OSHC-të mund të përfshihen në këtë proces.
2. Reforma e pushtetit vendor është duke u zhvilluar - aktualisht Shqipëria po rishikon rolin dhe përgjegjësitë e autoriteteve vendore. Ky është një moment i rëndësishëm për të siguruar që autoritetet vendore të fuqizohen si për të vendosur mbi shërbimet sociale lokale ashtu edhe për të patur fondet e nevojshme për të siguruar ofrimin e tyre.
3. Është zhvilluar Strategjia Kombëtare 2014-2020 - është e rëndësishme që ky dokument strategjik të theksojë veçanërisht se është e rëndësishme që kontraktimi social duhet të zhvillohet dhe të mbështetet nga shteti.
4. Karta për marrëdhëniet OShC - Qeveri është diskutuar në parlament - ky është një dokument i rëndësishëm që mund të nxjerrë në pah rolin e rëndësishëm të OSHC-ve

¹² Rregullat për Prokurimin publik, fq.9

¹³ Ligj 92/2014, dt. 24.07.2014, Mbi TVSH në Republikën e Shqipërisë, neni 51 Furnizimet e Përfshirë.

në ofrimin e shërbimeve sociale dhe nevojën për të siguruar se shërbime të tilla mund të kontraktohen te OSHC-të.

5. Një udhërrëfyes për zhvillimin e OSHC-ve është në përgatitje e sipër - Qeveria e Shqipërisë është duke punuar mbi një dokument që do të përshkruajë hapat që do të ndërmerren në drejtim të mbështetjes së zhvillimit të shoqërisë civile. Është e rëndësishme të theksohet që kontraktimi social është një nga fushat në të cilat përpjekjet duhet të investohen.

VII. REKOMANDIME

Bazuar në praktikat ndërkombëtare dhe situatën aktuale ligjore dhe praktike në Shqipëri, do të theksonim rekomandimet e mëposhtme. Qëllimi i tyre është të sigurohet që kontraktimi social është jo vetëm të jetë i mundshëm, por është edhe një praktikë kryesore në lidhje me ofrimin dhe financimin e shërbimeve sociale në Shqipëri.

- a. Duke pasur parasysh reformat që po ndodhin aktualisht në Shqipëri, duhet të sigurohet që **kontraktimi social të përfshihet si një prioritet i rëndësishëm në dokumentet e e politikave**. Gjithashtu, duhet të sigurohet që gjatë hartimit të ndryshimeve ligjore që kanë të bëjnë me reformat aktuale (p.sh. reforma e qeverisjes vendore apo reforma e përkujdesit social), kontraktimi social të jetë i rregulluar në mënyrën e duhur.
- b. **Aktorët kryesorë duhet të punojnë së bashku dhe të përcaktojnë elementet kryesorë të mekanizmit të kontraktimit social**, të cilat duhet të rregullohen më pas me ligj. Ky proces duhet të jetë një përpjekje e përbashkët e OSHC-ve, qeverisë qendrore dhe autoriteteve vendore për të siguruar që secili prej këtyre partnerëve kupton procesin dhe rolin e tij në të.
- c. Konsideratat më të rëndësishme në lidhje me mekanizmin përfshijnë:
 - 1) Përsa i përket shërbimeve sociale, është shumë e rëndësishme **që të ekzistojë mundësia për të lidhur kontrata shumëvjeçare me ofruesit**. Efekti cilësi për njerëzit mund të arrihet pas sigurimit afatgjatë të shërbimeve sociale dhe në qoftë se ne duam shërbime me cilësi të lartë, duhet t'u jepet një siguri e caktuar ofruesve të shërbimeve (që do të ofrojnë shërbim për një periudhë relativisht të gjatë), në mënyrë që ofruesit të investojnë në zhvillimin e shërbimit.
 - 2) Një tjetër çështje e rëndësishme ka të bëjë me **fleksibilitetin e financimit** dhe mundësinë që ofruesit të para-paguhet, në mënyrë që të jetë në gjendje të mbulojnë kostot e shërbimit. Një tjetër aspekt i fleksibilitetit është mundësia për të mbuluar kostot administrative që kanë të bëjnë me ofrimin e shërbimit dhe për të investuar çdo kursim në zhvillimin e shërbimit kundrejt kthimit mbrapsht tek autoriteti kontraktues.
 - 3) Një element i tretë i rëndësishëm konsiston që në nisje të procedurave të prokurimit, ku të jetë e mundur **përzgjedhja e ofruesit bazuar në kapacitetin e kandidatit dhe jo në ofertën më të ulët financiare**. Meqë fondet në fushën sociale janë të pakta dhe asnjëherë të mjaftueshme, është e rëndësishme që fondi i buxhetuar të përdoret për të arritur një shërbim me cilësi të lartë, ose për të mbuluar më shumë njerëz në nevojë, në vend që të konsiderohet një çmim më i ulët përkundrejt cilësisë.
 - 4) **Procedura duhet të jetë e thjeshtë (të mos krijohet barrë për ofruesit) dhe duhet të lejojë OSHC-të që të marrin pjesë në të** (duke pasur parasysh edhe kapacitetin e tyre dhe jo vetëm mundësinë ligjore për të marrë pjesë). OSHC-të janë ofruesit më të rëndësishëm të shërbimeve sociale dhe për këtë arsye duhet të sigurohet që në Shqipëri pjesëmarrja e tyre të mos pengohet për shkak të barrierave ligjore ose administrative.

- 5) **Procedura e kontraktimit social duhet të jetë e ndarë nga procedura e përgjithshme e prokurimit publik** për shkak të specifikave të tij dhe sidomos kërkesa që çmimi të mos jetë kriteri kryesor, sepse qeveria do të përcaktojë buxhete fikse bazuar në përlllogaritjet e kostove. Mekanizmi i kontraktimit social duhet të sigurojë që:
- i. Përzgjedhja të kryhet përmes një procesi transparent;
 - ii. Ka procese monitorimi mbi shpenzimet, cilësinë e shërbimeve dhe matjen e kënaqësisë e klientëve.
- 6) Ndërkohë që është e rëndësishme që të gjitha pjesët e mozaikut të gjejnë vendin e duhur, është e rëndësishme të fillohet me procesin e kontraktimit social sa më shpejt të jetë e mundur - përderisa **ekziston një mundësi ligjore dhe fonde të mjaftueshme për të kontraktuar disa shërbime**. Praktikimi i procesit do të ofrojë reagime të rëndësishme që do të ndihmojnë në përmirësimin e mekanizmit në të ardhmen.
- d. **Ekziston nevoja që të përshkruhen në mënyrë të qartë përgjegjësitë për ofrimin e shërbimeve sociale**. Aktualisht autoritetet vendore janë përgjegjëse për shërbimet sociale, por ka një përgjegjësi të përbashkët përsa i përket politikës sociale dhe reduktimit të varfërisë. Në të ardhmen, autoritetet vendore duhet të fuqizohen për të patur njëkohësisht përgjegjësinë për të vendosur mbi shërbimet sociale që do të sigurojnë, si dhe fondet e nevojshme për të siguruar ofrimin e tyre. Kjo duhet të jetë e shkruar në mënyrë të qartë në ligjet përkatëse që kanë të bëjnë me kompetencat e autoriteteve vendore.
- e. **Duhet të ketë fonde për ofrimin e shërbimeve sociale me bazë komunitare**. Fonde të tilla janë të nevojshme si në buxhetet e njërive të qeverisjes vendore ashtu dhe në buxhetin e shtetit. Si një hap i parë, në buxhetin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, përveç tre zërave ekzistuese të buxhetit (ndihmës ekonomike, ndihma e aftësisë së kufizuar dhe të institucioneve rezidenciale) një zë i ri duhet të shtohet në mënyrë specifike për shërbime sociale. Kjo mund të përdoret për sigurimin e fondeve për shërbimet sociale në nivel kombëtar (p.sh. një zë për gratë e dhunuara që mbulon gjithë territorin e Shqipërisë), si dhe për sigurimin e fondeve nga autoritetet vendore për të ofruar shërbimet e nevojshme sociale me bazë komunitare. Ky fond mund t'u jepet autoriteteve vendore në formën e mbështetjes nëpërmjet fondit të kushtëzuar, i cili do të përdoret me kusht që të kontraktohet te operatorët privatë. Nga ana tjetër, fondi mund t'u jepet autoriteteve vendore si një grant plotësues - për të dyfishuar çdo financim që autoritetet vendore përdorin nga burimet lokale për shërbimet sociale me bazë komunitare.
- Nga ana tjetër, autoritetet vendore duhet të përfshijnë në buxhetin e tyre fonde speciale për ofrimin e shërbimeve sociale me bazë komunitare, në një nivel minimal (p.sh. 5% të buxhetit vendor). Kjo duhet të sigurohet nga burimet e tyre lokale dhe duhet të jetë plotësuese për çdo fond që ata mund të marrin nga buxheti i shtetit për ofrimin e shërbimeve sociale.
- f. Është e nevojshme të sigurohet që në nivelin e qeverisjes vendore, **OSHCtë të përfshihen jo vetëm në ofrimin e shërbimeve sociale, por edhe në identifikimin e nevojave, planifikimin e shërbimeve sociale dhe në monitorimin e politikave sociale lokale**. Një nga hapat e parë që duhet të ndërmerren është hartëzimi i nevojave

të njerëzve në mënyrë që të kuptohet se cilat janë shërbimet që janë më të nevojshme në zona të ndryshme.

- g. **Nevojitet rritje e Kapaciteteve të OSHC-ve dhe institucioneve** në lidhje me procesin e kontraktimit social. Ka një nevojë për trajnime të specializuara që shpjegojnë se cili është qëllimi i kontraktimit social, cilat janë mundësitë ligjore, cilat janë procedurat ekzistuese, etj. Përveç kësaj, praktikat e mira nga Shqipëria dhe jashtë vendit duhet të ndahen në mënyrë që të dyja palët të kuptojnë vlerën e kontraktimit social.

Si konkluzion, edhe pse kontraktimi social nuk është i zhvilluar në Shqipëri për momentin, situata aktuale politike krijon një mundësi të rrallë për ta bërë këtë proces të suksesshëm. Përveç reformave që po zhvillohen, fakti se nuk ka pothuajse fare shërbime sociale me bazë komunitare krijon mundësinë që kur këto të fillojnë të zhvillohen. OSHC-të do të jenë partnerë kryesor, si të vetmet institucione që kanë përvojë dhe kapacitetet e nevojshme në ofrimin e shërbimeve sociale. Pra, në vend që autoritetet të investojnë shumë burime për trajnimin e punonjësve, ato mund të përfitojnë nga investimet që kanë bërë ndërkohë OSHCtë në burimet njerëzore. Sigurisht, OSHCtë duhet të zhvillojnë kapacitetet e tyre që të jenë në gjendje të mbulojnë grupe më të gjera përfituesisht, të ofrojnë shërbime të reja, etj. Por, procesi i kontraktimit social do të jetë një nxitje e natyrshme që ky proces të fillojë.

VIII. SHTOJCA

8.1. Rast Studimor - Komuniteti Emanuel, Korçë

Në vitin 2013, Komuniteti “Emanuel” në Korçë, nëpërmjet një marrëveshje kontraktuale me Bashkinë Korçë, të miratuar nga Këshilli Bashkiak, ka marrë mbështetje nga Bashkia në dy mënyra:

1. Fonde për pagesën e qerasë, faturave të energjisë dhe shërbimit të ujit të pijshëm, për dy Qendra komunitare : Qendra për Fëmijët Rome e Egjiptianë dhe Qendra Ditore për Moshën e Tretë.
2. Marrja në përdorim e hapësirave në pronësi të Bashkisë për vendosjen e dy qendrave komunitare: Qendra për Fëmijët Rome e Egjiptianë dhe Qendra Ditore për Moshën e Tretë.

Mbështetja financiare e dhënë nga Bashkia u përdor nga organizata për të mbuluar një pjesë të 15% të detyrimit të kostos së ndarë (cost share) që duhej të kontribuonte në një projekt të financuar nga një donator ndërkombëtar (saktësisht 4% të kësaj kostoje mbulonte fondi i dhënë nga bashkia për sa më sipër).

Kontrolli i auditit në bashkinë e Korçës, e gjykoj këtë procedure si jo të rregullt dhe jashtë ligjore. Financimi u konsiderua si “dhurim” për Komunitetin Emanuel, dhe argumentimi për paligjshmërinë e mbështetjes financiare, mbështetej në faktin se ligjërisht Njësitë e Qeverisjes Vendore nuk mund të japin “donacione” të kësaj natyre.

Në kontekstin social lokal, duke konsideruar edhe dëshirën dhe vullnetin e Bashkisë për të vijuar mbështetjen ndaj organizatës për dhënien e shërbimeve sociale për grupet në nevojë edhe gjatë vitit 2014, Bashkia e mundësoi këtë mbështetje për here të parë, nëpërmjet procedurave të Prokurimit Publik. Procedura e tenderimit ishte e llojit “Procedura e hapur”, ku të gjithë operatorët e interesuar mund të merrnin pjesë dhe kriteri i vlerësimit dhe përzgjedhjes së operatorit fitues ishte “oferta me çmimin më të ulët”.

Nën këtë praktike u zhvilluan dy procedura tenderimi:

1. Trajnimi për Qendrën për Fëmijët Romë dhe Egjiptianë
2. Aktivitete social kulturore për Qendrën Ditore për Moshën e Tretë (festa ditëlindjesh, ekskursione, etj.)

Komuniteti Emanuel mori pjesë në procedurat e tenderimit dhe u vlerësua nga komisioni si operatori fitues për këto thirrje të hapura (si operatori i vetëm që kishte aplikuar për këtë procedurë - një ofertë)

Aplikimi i tenderit u bë në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik. Organizata hasi probleme në regjistrimin në sistemin elektronik të prokurimit publik, pasi NIPT i saj nuk njihej në sistem dhe kjo e bënte të pamundur aplikimin e KE si operator për këtë thirrje.

Pas konsultimesh me stafin e njësisë së prokurimeve në bashkinë Korçë dhe këshillave të Agjencisë për Prokurimin Publik, organizatës iu sugjerua të dërgonte një kërkesë pranë APP, ku të shpjegohej statusi i tyre ligjor dhe forma e regjistrimit. Kërkesa u shoqërua edhe me NIPT dhe kopje të statutit të organizatës dhe u dorëzua pranë APP si dokument.

Pas kësaj procedure, organizata mundi të aksesonte sistemin elektronik të prokurimit publik dhe të aplikonte si operator në tender. Kjo ishte e para dhe e vetmja vështirësi që organizata hasi në këtë procedurë. Aplikimi on-line dhe çdo gjë tjetër gjatë procedurës rezultoi e lehtë.

Shuma e tenderuar ishte subjekt i TVSH, kështu që 20% e saj u zbrit nga vlera që ju kompensua organizatës për këtë shërbim. Bazuar në kontratën dypalëshe, organizata duhet të përgatiste një raport narrativ e financiar pranë Bashkisë çdo dy muaj, dhe pas miratimit të këtyre raporteve bëhet pagesa.

Raportimi dymujor, përpos pjesës narrative e financiare duhet të shoqërohej edhe me faturën që përshkruan shpenzimet që mbulohen nga bashkia dhe koston e tyre. Të gjitha shpenzimet e bëra nga organizata duhet të vërtetohen me faturat përkatëse dhe gjithashtu organizata duhet të përgatisë dhe lëshojë një fature për të gjithë shpenzimet e bëra.

8.2. Lista e të Intervistuarve

1. Vasilika Hysi – Deputete, Anëtare e Komisionit për Cështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, Kuvendi i Shqipërisë
2. Evis Qaja – Koordinatore, Njësia e Bashkëpunimit të Programeve Zhvillimore dhe Planifikimit Strategjik, Kryeministria
3. Enkelejda Lopari – Këshilltare e Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë
4. Eduard Ahmeti – Drejtor i Përgjithshëm, Agjencia e Prokurimit Publik
5. Reida Kashta (Shahollari) – Drejtoreshë, Drejtoria Juridike e Monitorimit dhe Publikimit, Agjencia e Prokurimit Publik
6. Lida Leskaj – Zv. Drejtoreshë e Përgjithshme, Shërbimi Social Shtetëror
7. Zarina Taja – Specialiste, Drejtoria e Politikave dhe Marrëdhënieve Fiskale, Ministria e Financave
8. Alketa Zazo – Oficere e Zhvillimit të Adolehentëve, UNICEF
9. Ilir Banushi – Nënkyetar, Bashkia Vlorë
10. Petro Thanasko – Përgjegjës, Njësia e Prokurimit, Bashkia Vlorë
11. Anjeza Shiko – Drejtoreshë, Drejtoria e Pronave Publike dhe Aseteve, Bashkia Vlorë
12. Jeta Xhabija – Përgjegjëse, Drejtoria e Shërbimit Social, Bashkia Shkodër
13. Armando Lohja – Përgjegjës i Zyrës së Kulturës, Bashkia Shkodër
14. Meme Xhaferraj, Drejtoreshë, Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Bashkia Durrës
15. Alvaro Kacupi, Specialist, Njësia e Prokurimit, Bashkia Durrës
16. Xheni Prenda, Drejtoreshë, Drejtoria e Politikave dhe Projekteve Strategjike, Bashkia Korçë
17. Matilda Stena – Përgjegjëse e Sektorit të Prokurimeve, Bashkia Korçë

8.3. Pjesëmarrësit në grupe të fokusuara me OSHCtë

Korçë

1. Robert Stratobërdha – Ndhimë për fëmijët, Korçë
2. Rudina Lako – Ndhimë për fëmijët, Korçë
3. Mirela Kapedani – Ndhimë për fëmijët, Korçë
4. Kristi Ziko – Dorcas
5. Gerta Kajno – Fondacioni Tabita
6. Aldi Stratobërdha – Misioni Emanuel
7. Nonda Kajno – Agjencia Artistike e Spektakleve Korça
8. Petrika Riza – Dora Prindërore
9. Violeta Tici – Klubi Social
10. Klara Çelo – Gruaja Korçare
11. Klementina Fundo – Gruaja Korçare
12. Dhionis Kotrilo – Natyra dhe Jeta
13. Meri Pollasni – Porta Evropiane Qarku Korçë
14. Natasha Buzhali – Nëna, Fëmijët e Ardhmja
15. Irena Fecani – Aleanca e Shoqerise Civile
16. Isuf Salice – Shoqata e Perfitimit Fizik
17. Niko Balli – Shoqata e AgroTurizmit

Tiranë

1. Rajmonda Prifti – Shoqata për Gratë dhe Fëmijët
2. Afërdita Seiti – Shoqata "Ndhimoni Jetën"
3. Marjeta Manushaj – Qendra e Zhvillimit "Shtëpia e Kuqe"
4. Besa Rroshi – Komuniteti Emanuel
5. Migena Loli – SOS Fshatrat e Fëmijëve
6. Ada Dimo – ARSIS
7. Miloim Demnushaj – Të Ndryshëm & Të Barabartë
8. Vilma Gjeci – Tirana Legal Aid Society
9. Alketa Kupe – Terre des Hommes

Vlorë

1. Enela Mane – Qendra Aulona
2. Egla Imeraj – Qendra Aulona
3. Adena Vangjeli – Qendra Vatra
4. Hodo Kabelle – Intelektualët e Pavarësisë
5. Luljeta Gusha – Fëmijët dhe Nëna në Fokus
6. Alketa Dhimitri – Qendra Rinore
7. Marinela Deraj – Qendra e Informacionit Aarhus

Durrës

1. Viola Cikalleshi – Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen”
2. Mirjam Reçi – Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile
3. Marjana Biba – Shoqata Kombëtare e Jetimëve të Shqipërisë, Durrës
4. Migena Mehmeti – Shoqata “Shpresë për Jetimët”
5. Vangjeli Cugaj – Shoqata “Shpresë për Jetimët”
6. Llesh Arapi – Shoqata “Nënë Tereza”
7. Nikolla Gogo – Shoqata “Solidaritet, Miqësi, Handikap”

Shkodër

1. Antonjeta Pero - Qendra Këshillimore Për Njerëzit Me Aftësi Të Kufizuar
2. Kastriot Faci - THE DOOR
3. Fatmir Lugji - YMCA Shkodër
4. Pranvera Marku - Shpresë për të Ardhmen
5. Kristi Kola - Gruaja tek Gruaja
6. Armando Lohja - Creative City
7. Entela Shkreli - GO2
8. Arbana Dibra

Partnerët Shqipëri është një organizatë lokale e themeluar në vitin 2001, që punon për të ndërtuar platforma bashkëpunimi mes organizatave të shoqërisë civile, pushtetit vendor dhe qendror, komunitetit të biznesit dhe medias, për një zhvillim të qëndrueshëm social-ekonomik të shoqërisë dhe demokracisë në vend.

Partnerët Shqipëri, Qendra për Ndryshim dhe Manaxhim Konflikti

Rruga Sulejman Delvina, N.18, H.8, Ap. 12, Njësia Bashkiake 5,

Kodi Postar 1022, Tiranë, Shqipëri,

Kutia Postare (PO Box) 2418/1

Tel. 04 2254881 Fax: 04 2254883

Email: partners@partnersalbania.org

<http://www.partnersalbania.org>